

KËRKESË

PËR SHPALLJEN TË VDEKUR TË RAMAZAN ZENUN ZUNËS GJYKATËS SË RRETHIT TË BULQIZËS

Kërkuesi: Zenun Zuna, i biri i Sadikut dhe I Bedries, i datëlindjes 1935, i lindur dhe banues në Klenjë të rrethit Dibër.

Objekti: Deklarimin e vdekjes së Ramazan Zenun Zuna në bazë të nenit 15 e vijues të Kodit Civil dhe të nenit 375 e vijues të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë. Në gusht të vitit 1990 djali im Ramazani ka kaluar kufirin shtetëror afër Streblevës dhe është larguar për në Jugosllavi. Këtë fakt unë e vërtetoj pasi pas disa muajsh e konkretisht pas gjashtë muajsh kam biseduar në telefon me të. Nga biseda me të midis të tjerash më tha se ai banonte i strehuar në një hotel të Beogradit të quajtur “OVALA” dhe se po interesohej që të bënte dokumente pasi kishte dëshirë që të largohej nga Jugosllavia për në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Pas kësaj bisede ai më dërgonte herë pas here letra dhe me të jemi marrë vesh vetëm në këtë rrugë korrespondence. Kjo gjë vazhdoi deri në korrik të vitit 1991, kohë në të cilën më ka ardhur një letër anonime në adresën time nga Beogradi me këtë përmbajtje: “E marr këtë letër që të shkruaj por nuk ma bënë dora e zemra për të shkruajtur, por po ju njoftoj se Ramazani është vlarë nga shefi i hotelit “OVALA” të Beogradit”.

Për këtë fakt sqaroj se letra anonime ishte e shoqëruar edhe me një fotografi të prerë në kuptimin që djali im Ramazani kishte pozuar në atë fotografi me një person tjetër.

Gjithashtu, sqaroj se shkrimi i asaj letre nuk ishte i djalit tim pasi unë do ta njihja menjëherë atë.

Pas marrjes së letrës dhe për të sqaruar më tej iu drejtova Ministrisë së Punëve të Jashtme, por nuk më dhanë përgjigje deri më sot. Iu drejtova Ministrisë së Punëve të Brendshme . Pas rreth një viti më thiri shefi i Komisariatit Bulqizë dhe më tha se nga interesimet tona me anë të INTERPOLIT rezulton se ai nuk ka qenë i regjistruar nëpër kampet e Beogradit dhe asnjë shpjegim më tej.

Në këto rrethana nuk më mbetet gjë tjetër veç se të kërkoj në rrugë gjyqësore deklarimin e zhdukjes apo të vdekjes të djalit tim Ramazan Zuna.

KËRKUES
Zenun Zuna